



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



## PROCESVERBAL 6/2024

I Mbajtur në takimin e VI- të rregulltë të KPF-së me datën **18.06.2024**, në ora **10<sup>00</sup>** në zyrën e takimeve te Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

1. z. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. z. Arian Imeri, Anëtar
3. znj. Lumnije Morina, Anëtare;
4. znj. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. z. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. z. Brahim Osmani, Anëtar;
7. znj. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. znj. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. z. Flamur Istrefi, Anëtar dhe

**Drejtoret e drejtorive;**

1. z. Afrim Llabjani - Drejtor i Arsimit;
2. z. Arbër Bytyqi - Drejtor i Urbanizmit dhe Mjedisit;
3. znj. Sebahate Ajeti Sadiku - Drejtore e Buxhetit dhe Financave.

**Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi** – Përvendosje të pranishëm, anëtarë të kuvendit, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e VI-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

**Rendi i ditës:**

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;

4. Propozim-Vendim për miratimin e Kornizës A fatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027;
5. Të ndryshme.

#### Pikat shtesë:

1. Propozim - Vendim për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Ferizajt;
2. Propozim-Vendim për emërtimin e dy anëtarëve të komisionit përgjedhës nga Kuvendi i komunës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave.
3. Propozim-Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 40 të datës 30.05.2024 për Komisionin e Emërtimit të rrugëve, Rrugicave dhe shesheve për kompletimin e sistemit të adresave komunale.

#### Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush rreth rendit të ditës?

**Afrim Llabjani** - Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e Komitetit, kërkoi falje që materialin e kemi pru në këtë formë, në fakt të ndryshimit që është dashur për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Rregulloren në parim që të nisim si procedurë, po pasi që po vonohet na mendojmë që t'a marrim një vendim ose propozim në Komitet, e mandej të kaloi në kuvend për miratim, e në fakt për zgjedhjen e komisionit të dy anëtarëve që i përket për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, kemi pasur edhe një herë në votim këtë komision po duhet me përsërëtë, është fjala për z.Bashkim Bytyqi si Zyrtar i lartë i arsimit si Kryetar i komisionit dhe znj. Mendehie Lekaj Rexhaj – anëtare, është profesoresh dhe kemi sjellur nga një kopje të biografisë së tyre dhe besoi që me mirëkuptimin e juve kalon në kuvend.

#### Pika shtesë të rendit të ditës;

1. Propozim-Vendim për emërtimin e dy anëtarëve të komisionit përgjedhës nga Kuvendi i komunës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave.

#### Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, dikush tjetër, urdhëro drejtor.

**Arbër Bytyqi** - Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, këtu kam sjell një propozim prej Drejtorisë së Urbanizmit përmes Zyrës së kryetarit të komunës pikën: Propozim-Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Ferizajt; dihet që Planit Zhvillimor Komunal ekzistues i skadon afati në Shtator të Viti 2025, prandaj kërkoi që të përcillet në kuvend dhe të kërkohet procedura për Hartimin e Planit të ri Zhvillimor Komunal 2025-2033, faleminderit.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Faleminderit Drejtor, dikush tjetër, pra kemi dy propozime të reja si pika shtesë për kuvend;

1. Propozim-Vendim për emërtimin e dy anëtarëve të komisionit përgjedhës nga Kuvendi i komunës për zgjedjen e drejtoreve dhe zëvendësdrejtoreve të shkollave dhe
2. Propozim - Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Ferizajt, kush është për këtë rend dite, faleminderit; 9 vota për, kundër 0, abstenim 0, vazhdojmë me rendin e ditës.

### Pika 3

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Miratimi i procesverbalit të KPF-së, materialin nuk e kemi të gatshëm me procedu kështu vazhdojmë me pikën IV-të të rendit të ditës.

### Pika 4

Propozim-Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027, urdhëro drejtore.

**Sebahate Ajeti Sadiku** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishëm, unë kerkoi falje që materialin për Projekte kapitale 2025-2027 e keni marr për korniza afatmesme buxhetore dhe meqenëse mbas takimit i kemi ba disa ndryshime jemi detyru që t'i korrigojmë projektet pas përgatitjes finale të tyre, me gjithë atë me aprovimin e Kornizës Afat Mesme Buxhetore mirët qarkorja e dytë për aprovimin e buxhetit në shtator në kuvend, materialin e keni marr me kohë, faktikisht shumicën e materialit dhe si të tillë kerkoi që të procedohet për kuvend në mënyrë që të diskutojmë më tutje, faleminderit.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutojë, për Kornizën Afat Mesme Buxhetore, urdhëro.

**Arian Imeri** – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, na këna biseduar me kryetar të fshatrave që ki qenë pjesëmarrëse edhe t'i aty dhe kena dhanë disa propozime aty, a e keni iden sa propozime janë përfshirë aty.

**Sebahate Ajeti Sadiku** – Projektet janë nda në drejtori dhe realisht aty jemi mundu që secili lokalitet ta merr nga një projekt, besoi që janë të përfshimë aty, të paktën prej të gjitha fshatrave jemi munduar të përfshihet nga një projekt që është kérku, sidomos në projektet e Drejtorisë së infrastrukturës, shpesh herë kemi pas edhe kërkesa për kanalizime, na e këna një kontratë nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Shërbimeve publike që i mbulon të gjitha ato shërbime,

megjithëse nuk mundemi me i mbulu të gjitha, për shkak të buxhetit, të gjitha t'i realizojmë, por ku ka intervenime mujna me i realizu ato intervenime, bëhet reduktimi, kyqja ose mirëmbajtja e kanalizimeve, njejtë e ka titullin projekt, e projektet të tjera për asfaltimin e rrugëve nëpër fshatrave janë të përfshira me Drejtorinë e Infrastrukturës, kemi pasur kërkesa edhe për rritje të buxhetit për krijimin e hapësirave të gjelbërtë, faktikisht që është projekt në drejtorinë e infrastrukturës, brenda mundësive buxhetore jemi munduar sado pak ta rrisim projektin ekzistues në mënyrë që në të ardhmen t'i fusim në buxhet dhe në të ardhmen të krijojmë hapësira më të mëdha, më shumë aty ku ka nevojë dhe kërkohet, projekt i është rritur 700, po ta vlerësojmë edhe qarkoren e dytë nëse është rritur buxheti në krahasim me qarkoren e parë.

**Arian Imeri** – Me rritjen e popullsisë a do të ketë ndryshime?

**Sebahate Ajeti Sadiku** – Po me rritjen e popullsisë realisht duhet ta presim qarkoren e dytë me 15-20 Korrik, mandej nëse publikohen të dhënat zyrtare, besoi që edhe qeveria do të mujë të reflektonë në bazë të numrit të ri të popullsisë, po megjithatë nëse nuk publikohet simbas të dhënave statistikore të Republikës së Kosovës, para se të na vije qarkorja e dytë, atëherë nuk besoi që do të kemi ndryshime.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Faleminderit, Dikush tjetër, me sa duket nuk ka të tillë, duke pasur parasysh se është një orientim buxhetor edhe për projekte edhe për këshillat buxhetore.

**Sebahate Ajeti Sadiku** – Kryesues edhe diçka harrova me potencu, na ndodhë që na faktikisht kemi rritje të buxhetit, por çka duhet na me potencu dhe çka është reflektu më tepër që është rritur tavani i të hyrave vetanake d.m.th. nuk është rritur ku me ditë sa gradi i përgjithshëm sa është rrit tavani i të hyrave vetanake, na deri këtë vit e kemi pasur 6.500,000.00€ tavanin e të hyrave vetanake, prej vitit të ardhëshëm e kemi 8,500,000.00€, 9,500,000.00€, e që i bie që buxheti në total ka rritje të hyrave prej 2,000,000.00€, është refleks i rritjes së tavanit të hyrave, e që si komunë uroi që të arrimë këtë tavan, meqenëse vazhdimit kemi arrit tejkalimin e rritjen e të hyrave, e ta shohim edhe në vitin e ardhshëm.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Faleminderit Drejtore.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – D.m.th. parashikimet për Buxhetin 2025-2027 janë të parashikume, sepse si e tha drejtorja varësisht prej asaj se si e parashev Qeveria me qarkoret buxhetore gjithmonë para aprovimit të buxhetit i lanson nëpër komuna dhe varet tash prej Qeverisë, se a na lejon me ngrit apo na detyron me zbrit, është çështje relative kjo punë, na i kemi parashikimet tonë, pastaj simbas vendimeve që na vinë i aprovojna.

**Sebahate Ajeti Sadiku** – Kryesues edhe diçka ju kisha lutë, rast konkret e kemi buxhetin e këtij viti, në bazë të qarkores së parë e kemi ba për herë të parë KAB-in, në qarkorën e dytë na patën obligu që u patën rrit pagat, përshak të kategorisë së pagave dhe ligjtë pagave na patën obligu me i humbur të gjitha kategoritë tjera, pra nuk kemi pas buxhet shtesë por njejtë e kemi edhe këtë vit, në qoftëse nuk na obligojnë me i rrit ose me i ulë kategoritë tjera prapë për rritje të pagave, sepse sipas parashikimeve të qarkores së parë jemi në rregullë, por megjithatë kontrata kolektive nuk është parapa edhe neve vazhdueshëm po na afrohet që jemi në minus të kësaj kategorie të pagave, shpresoi që edhe vitin e ardhshëm do të kemi edhe një pikë të rendit të ditës për buxhet në transfer, në qoftëse nuk na mbulon Qeveria, nëse do të kemi mundësi të jekim ndonjë projekt kapital, obligim e ka kontratën kolektive me ba.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – A jeni për këtë rend dite që të kaloi për kuvend; kush është për; 9 vota për, faleminderit, a ka kundër 0, abstenim 0, vazhdojmë me pikën e V-të të rendin e ditës.

## Pika 5

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Propozim-Vendim për emërtimin e dy anëtarëve të komisionit përgjedhës nga Kuvendi i komunës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, drejtor a i keni emrat apo jo?

**Afrim Llabjani** – Po kryesues e keni shkresën, dhe Propozim – Vendimin.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – A dëshiron dikush të diskutoi për këtë pikë të rendit të ditës, apo ta kalojmë për kuvend; kush është që të kaloi për kuvend; 9 vota për, faleminderit, a ka kundër 0, abstenim 0, vazhdojmë me pikën e VI-të të rendin e ditës.

## Pika 6

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Propozim-Vendim për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 të Komunës së Ferizajt; Drejtor e ki fjalën, apo ta procesojmë për kuvend.

**Arbër Bytyqi** - Faleminderit Kryesues, ky propozim është sjellë në KPF dhe të hynë si fillim i procedurës, mandej ka me u shpallë procedura e diskutimeve publike me qytetarë dhe shqyrtimëve dhe të sjellët në kuvend për me u miratu, kjo është vetëm si fillim i procedurës në Shtator të Vitis 2025, meqenëse Komuna e Ferizajt nuk ka kapacitet për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 dhe presim nga jashtë. Kjo është vetëm fillimi i procedurës, fillimi duhet të kalohet përmes kuvendit, pastaj ne të vazhdojmë me procedura tjera.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Faleminderit Drejtor, është mirë me pas parasysh kohën e periudhës, jetëgjatësinë, politikat edhe pse është pak e pa mundur për 8 vjet me parapa se çka ka

me ndodhë, por do ta shohim me mundësi, e aq sa është e mundur është mirë me dhanë maximumin.

**Arbër Bytyqi** - Kryesues na duhet me dhanë maximumin me gjetë një zgjidhje, e në përgjithësi na si popull kemi telashe me planifikim.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Paraprakisht kush e ka pru PZHK-në, fillimisht e kanë pru bile edhe emrin ja di.

**Arian Imeri** – Kompania që e ka pru PZHK-në, me ja dhanë arkitektave, me pas ekip me ba planin zhvillimor komunal, ne nuk mundemi mu u ba vend dërkombëtar.


**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – A ka dikush tjetër, kush është që të kaloi për kuvend; 9 vota për, faleminderit, a ka kundër 0, abstenim 0 pra kalon edhe nëse ka dikush në të ndryshme.

**Flamur Istrefi** - Në bazë të informatave që kemi jashtë ka pasur blllokim të procesit dhe shqetësim.


**Arber Bytyqi** - Të mërkurën e kam marr vendimin dhe kam pas takim me komisionin, sot kam pas dëshirë të jem pjesë e takimit, dikush i komisionit nuk ka mundësi të punojë sot dhe e vazhdon nesër, në pikën që është për ndryshim e vazhdon në seancë, nuk mundet me mbet pengë kuvendi komunal me predikimet e dikuja, nëse vijnë është në rregulle, e nëse nuk vijnë na kena me vazhduar brenda kohës ligjore e nëse nuk vazhdojmë kjo është veprë penale.

**Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi** – Dikush tjetër, siç po shifet nuk ka, faliminderit për pjesëmarrje, pra e shpalli të mbyllur mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Procesmbajtësja



Zyliha Tafarshiku



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi